



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nr. 126/6 prot**

**Datë 21.02.2023**

**V E N D I M**

**Nr. 129/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.02.2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Anulimi i shortit të hedhur në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-54848-12-22-2022, me objekt: “Shërbime të ruajtjes dhe të sigurisë” Drejtorisë Shërbimit Spitalor Librazhd - Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj” me fond limit 25,508,841 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 098.01.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Librazhd.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kumria 1” SHPK në procedurën e prokurimit.

**Ankimues:** “Nazeri 2000” SHPK.  
Rruga e Kavajës, Qendra Condor, Kati 2, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd  
Rruga: “Jahup Biçaku“ lagjja Nr. 2, Librazhd

**Subjekte të Interesuar:** “Kumria 1” SHPK  
L. “11 Nentori”, Rr. “Shefqet Daiu”, Banese private nr 21, Elbasan

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

**Vëren:****I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.12.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-54848-12-22-2022, me objekt: “Shërbime të ruajtjes dhe të sigurisë” Drejtorisë Shërbimit Spitalor Librazhd -Marrëveshje Kuadër – me

*nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj” me fond limit 25,508,841 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 098.01.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd.*

II.2. Në datën 13.01.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Kumria -1” SHPK 24.788.841,22 lekë, kualifikuar
2. “Nazeri 2000” SHPK 24.788.841,22 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 19.01.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit, ku rezulton fitues shoqëria “Kumria-1” SHPK.

II.4. Në datën 23.01.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është administruar ankesa me nr. 126 protokoli e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-54848-12-22-2022, me objekt: “Shërbime të ruajtjes dhe të sigurisë” Drejtorisë Shërbimit Spitalor Librazhd -Marrëveshje Kuadër – me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj” me fond limit 25,508,841 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 098.01.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd dhe në datën 24.01.2023 ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Kumria -1” SHPK si dhe kundërshtohet mënyra e hedhjes së shortit nga ana e KVO-së. Konkretisht pretendohet si vijon:

*“Ne datën 16.01.2023, nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike portalit app [www.gov.al](http://www.gov.al) në llogarinë e përdoruesit në rubrikën kërkesa nga AK na vjen njoftimi “ I nderuar operator ekonomik ju keni marrë pjesë në procedurën e zhvilluar nga autoriteti kontraktor me objekt "Shërbime të ruajtjes dhe të sigurisë fizike” Drejtorisë Shërbimit Spitalor Librazhd. Pas përfundimit të fazës së vlerësimit të dokumentacionit të dërguar nga ana Juaj na rezulton se Ju keni paraqitur ofertë ekonomike në vlerën prej 24,788,841.22 lekë pa TVSh e cila është e njëjtë me ofertën ekonomike të paraqitur nga një operator tjetër ofertues. Në respekt të ligjit Nr.162/2020,datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ju njoftojmë se në datë 17.01.2023 ora 15.00 autoriteti kontraktor sipas adresës të përcaktuar në dokumentacionet e tenderit do të zhvillojë procedurën e shortit. Përfaqësuesi Juaj duhet të jetë i pajisur me autorizim nga ana Juaj dhe me vete duhet të ketë edhe Kartën e Identitetit, për të marrë pjesë në këtë procedurë shorti. Mos pjesëmarrja në këtë procedurë nuk pengon vazhdimin e procedurës së shortit. Ju faleminderit!”.*

*Për sa me sipër, ne datën dhe orën e caktuar nga AK-ja në ambientet e Drejtoria e Shërbimit Spitalor Librazhd, në zyrën ku do hidhej shorti në prani të komisionit u paraqiten përfaqësuesit e shoqërisë sonë së bashku me përfaqësuesit e firmës Kumria 1.*

*Komisioni i perbere nga 5 persona, ndermjet te cileve arshivisti dhe nje i cili u prezantua mbikeqyres i shortit, kerkuan autorizimet e perfaqesuesve te firmave te cilet ja paraqiten bashke me kartat e identitetit bashkangjitur. Perfaqesuesi i shoqerise sone, duke qene se ne njoftimin e derguar nga AK nuk shprehej se cilet ishin anetaret e komisionit, kerkoi qe komisioni te prezantohet per t'u njohur me perfaqesuesit e AK qe do te realizonin hedhjen e shortit.*

*Nderkohe qe asnjë prej anetareve te komisionit jo vetem qe nuk u prezantuan por edhe refuzuan te prezantoheshin pa asnjelloj arsyetimi duke krijuar nje situate te çuditshme dhe te pa shpjgueshme. Gjithashtu perfaqesuesi i shoqerise sone kerkoi qe nje nga anetaret te mbante procesverbal ku te pasqyrohet prezenca e perfaqesuesve te OE dhe prezenca e perfaqesuesve te AK si dhe menyra e hedhjes se shortit. Verbalisht na u tha qe perfaqesuesi i OE Kumria 1 duhet te terhiqte i pari, pasi sipas sistemit te prokurimeve elektronike rezultonte i pari. Kjo gje nuk eshte e vertete pasi, kur u kerkua nga ana jone qe te shikohej sistemi i prokurimeve elektronike dhe te verifikohet se kush ishte i pari nga ana e komisionit, nuk u pranua dhe na u paraqit nje flete A4 e printuar ku tregohej radha e Operatoreve Ekonomik (cdo flete eshte e printuar nga sistemi i operatorit ekonomik Kumri 1 dhe kerkojme verifikimin nga ana e APP dhe KPP) bashkengjitur e ngjashme me fleten qe kishte komisioni dhe operatori ekonomik. Te njejten flete kishte dhe perfaqesuesi i Kumria 1 ne xhep. Perfaqesuesi jone kembenguli qe te shikohej sistemi i prokurimeve elektronike dhe ne pamundesi te perzheshin zarfat nga te tre antaret e komisionit dhe te liheshin mbi tavoline. Kryetarja e komisionit vazhdoi duke bere sikur perziente zarfat dhe duke ja dhene ne dore zarfin fitues perfaqesuesit te KUMRIA 1 pa i lene zarfat ne tavoline. Nga ana e perfaqesuesit tone nuk u pranua ky fakt por komisioni vazhdoi me shkelje te tjera, duke mos dhene me asnje shpjegim. Perfaqesuesi jone kerkoi procesverbalin e shortit por nga ana e komisionit u tha qe duhesh bere kerkese me shkrim ne menyre qe te kthehesh pergjigje me shkrim.*

*Shorti i zhvilluar ne daten 17.01.2023 është i parregullt, jo transparent dhe jo i bazuar ligjrisht pasi nga ana e autoritetit kontraktor nuk u mbajt procesverbal per fazën e parë të hedhjes së shortit, fazë kjo që rendit sipas rradhës operatorët ekonomikë për përzgjedhjen në fazën e dytë të shpalljes fitues, gjithashtu edhe në fazën e dytë të hedhjes së shortit ka patur kontestime dhe pretendimi nga ana shoqerise sone në lidhje me zarfat qe ata do të tërhiqnin pasi ishin të hapur të pa mbyllur. Nga ana e perfaqesuesit tone u kerkua edhe njehere procesverbali po komisioni mbylli zyrat dhe u largua pa dhene me asnje shpjegim.*

*Ndodhur ne kushtet e siperpermendura, nga ana e AK duhet te rivendoset e drejta jone duke u anuluar shorti i dates 17.01.2023 dhe te zbatohen te gjitha procedurat e nevojshme ose ne rastin me te keq per shkak te shkeljeve te kryera do te jemi te detyruar ti drejtohem te gjitha instancave ligjzbatuese.*

*Sa me siper, ne perputhje me dispozitat ligjore autoriteti duhet te korigjoe shkeljet e kryera duke anuluar shortin e dates 17.01.2023.*

*Gjithashtu shoqëria “Nazeri 2000” SHPK pretendon se:*

*Se pari, AK duhet te skualifikoje oferten e shoqerise KUMRIA 1 pasi nuk eshte llogaritur si duhet dhe eshte nen koston ligjore.*

*Shoqeria KUMRIA 1 nuk ka llogaritur si duhet shtesat e turnit te dyte dhe te trete pasi i ka llogaritur me mesataren mujore 30.41 nderkohe qe ne referuar njoftimit mbi "Rekomandimin mbi menyren e zhvillimit te procedures se prokurimit per sherbimin e privat te sigurise fizike" te KPP, ne procedurat me afat 3 vjecar ne te cilen perfshihet edhe muaji shkurt me 29 dite, perlllogaritjet e zerave te kostos lidhur me shtesat e turnit te dyte dhe te trete mbi pagen baze per nje roje ne muaj duhet te llogariten me mesataren mujore 30.44 dite ne muaj.*

*Kerkojme nga AK te skualifikoje shoqerine Kumria 1, pasi ka ofertuar nen koston ligjore per sherbimin e kerkuar, si dhe te shpalle fituese shoqerine "NAZERI 2000" pasi oferta e paraqitur permbush te gjitha detyrimet ligjore.*

*Se dyti, Autoriteti Kontraktor duhet te skualifikoje shoqerine KUMRIA 1 pasi nuk ploteson kerkesen e dhene ne DST shtojca 9, pasi nuk keni plotesuar sakte formularin permbledhes te vetedeklarimit dhe nuk keni deklaruar drejtuesin teknik dhe te gjithe personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, te cilet kanë kompetenca përfaqësuese vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik,*

*Se treti, Autoriteti Kontraktor duhet te skualifikoje shoqerine KUMRIA 1 pasi nuk ploteson kerkesen e dhene ne dst 2.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë pika 2.1.1, pasi licenca e shoqerise nuk ka te bashkengjitur vendimin e Drejtorit te Pergjithshem te Policise se Shtetit.*

*Se katerti, Autoriteti Kontraktor duhet te skualifikoje shoqerine KUMRIA 1 pasi nuk ploteson kerkesen e dhene ne dst 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 2.2.1, pasi nuk keni paraqitur pasqyrat financiare per vitet e fundit 2019-2020-2021 sipas ligjit, pasi nuk kane te bashkangjitur raportin e auditimit për pasqyrat financiare sikurse parashikohet ne nenin 41 te ligjit 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.*

*Shoqeria KUMRIA 1 duhet te skualifikohet pasi permbush dy nga kushtet e nentit 41 germa c, te ligjit 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar".*

*Në nenin 41, shkronja "c":*

*"c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:*

*i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;*

*ii)shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;*

*iii)ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."*

*Te njejtin qendrim mban edhe KPP me vendime te ngjashme nr. 581/2019 date 03.09.2019 ku shprehet se: "Referuar bazes ligjore te sipercituar, KPP morri ne shqyrtim dokumentacionin e dorezuar prej operatorit ekonomik te siperpermendur, per te verifikuar nese ky ofertues*

*permbush dy nga kushtet Kumulative te parashikuara ne ligjin e sipercituar per auditimin e pasqyrave financiare. KPP referuar pasqyrave financiare te dorezuara nga ofertuesi “Myrto Security” ShPK per vitin 2018 permbush kushtet per totalin e aktiveve te bilancit dhe shumen e te ardhurave nga veprimtaria ekonomike, prandaj ka patur detyrimin per te paraqitur raportin e ekspertit kontabel te miratuar per bilancin e vitit 2018, sikurse parashikohet ne bazen ligjore te siperpermendur.*

*Se pesti, Autoriteti Kontraktor duhet te skualifikoje shoqerine KUMRIA 1 pasi nuk ploteson kerkesen e dhene ne dst 2.3 Kapaciteti teknik pika 2.2.4, pasi ne vertetimin e performances se paraqitur nuk jepen te dhena te sakta per drejtuesin teknik aktual te cilin e ka te deklaruar ne QKB por jepen per drejtuesin teknik te vjeter i cili eshte larguar.*

*Se gjashti, Autoriteti Kontraktor duhet te skualifikoje shoqerine KUMRIA 1, pasi nuk ploteson kerkesen e dhene ne dst 2.3 Kapaciteti teknik pika 2.2.5, pasi drejtuesi teknik nuk eshte i siguruar tre muajt e fundit ashtu si kerkohet ne DST.”*

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 126/2 prot datë 24.01.2023, me kriteret e kualifikimit të cilat pretendohen se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Kumria-1” SHPK, si dhe pretendimet lidhur me ofertën ekonomike të shoqërisë “Kumria-1” SHPK dhe pretendimet për hedhjen e shortit nga ana e KVO-së.

II.6. Në datën 01.02.2023 është protokollur në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 126/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 66/12 prot., datë 30.01.2023 me objekt: “Kthim përgjigje ankesës për procedurën e prokurimit “Shërbimi i ruajtjes dhe i sigurisë fizike”, drejtuar operatorit ekonomik ankimes “Nazeri 2000” SHPK dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes “Nazeri 2000” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 126/4 prot., datë 07.02.2023 me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion si vijon: “[...] Rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dërguar informacion i hollësishëm lidhur me zhvillimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, si dhe nuk është paraqitur në KPP dokumentacioni i mbajtur nga KVO-ja lidhur me hedhjen e shortit për ofertat ekonomike me vlerë të njejtë, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin e sipërcituar. Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë

*pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” SHPK, si dhe të paraqiten procesverbalet e punës së KVO-së si dhe gjithë dokumentacioni përkatës lidhur me hedhjen e shortit në këtë procedurë.”*

II.8. Në datën 13.02.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 126/5 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 66/14 prot., datë 10.02.2023 me objekt: “*Dhënie informacioni lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” SHPK*”, bashkëngjitur procesverbalet e punës së KVO-së si dhe dokumentacioni mbi trajtimin e ankesës.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik,**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” SHPK se: “*AK duhet te skualifikoje oferten e shoqerise KUMRIA 1 pasi nuk eshte llogaritur si duhet dhe eshte nen koston ligjore. Shoqeria KUMRIA 1 nuk ka llogaritur si duhet shtesat e turnit te dyte dhe te trete pasi i ka llogaritur me mesataren mujore 30.41 nderkohe qe ne referuar njoftimit mbi “Rekomandimin mbi menyren e zhvillimit te procedures se prokurimit per sherbimin e privat te sigurise fizike” te KPP, ne procedurat me afat 3 vjecar ne te cilen perfshihet edhe muaji shkurt me 29 dite, perllogaritjet e zerave te koston lidhur me shtesat e turnit te dyte dhe te trete mbi pagen baze per nje roje ne muaj duhet te llogariten me mesataren mujore 30.44 dite ne muaj. Kerkojme nga AK te skualifikoje shoqerine Kumria 1, pasi ka ofertuar nen koston ligjore per sherbimin e kerkuar, si dhe te shpalle fituese shoqerine “NAZERI 2000” pasi oferta e paraqitur permbush te gjitha detyrimet ligjore*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 2 “Lista e çmimeve të shërbimeve”, të dokumenteve të tenderit të mësipërm, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si vijon:

**Shtojca2.** (Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_ **Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të pa ofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>
<b>Arti</b>	<b>Përshkrimi i shërbimit</b>	<b>Njesia (muaj)</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi leke</b>	<b>Çmimi total për shërbimin (leke)</b>
1	Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise DSH Spitalor Librazhd me roje me tre turne 24 ore	36 muaj	2 vendroje x 4.98 roje/ved = 9.96 roje		
2	Sherbim ruajtje me sistem alarmi dhe monitorim kamera vëzhgimi non stop 24 ore, shtojca 5 specifikim teknike	36 muaj	2 sist alarmi + 2 kamera vëzhgimi monitorim 24 ore		
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					

**Sqarime**



1. *Ne çmim te perfshihen te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, shtesat mbi page, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes per vend roje me tre turne.*
2. *Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe nje vend-roje me tre turne në muaj.*

Nr.	Emërtimi
1	<i>Shpenzime për pagë bazë</i>
2	<i>Shtesë mbi pagë për turnin II</i>
3	<i>Shtesë mbi pagë për turnin III</i>
4	<i>Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%</i>

#### *Analiza e kostos*

- *Operatorët janë të detyruar të paraqesin analizën e detajuar me menyren e perlllogaritjes se koston për ofertën e paraqitur si dhe preventivin sipas zerave te mesiperme, duke pasqyruar te gjitha kostot per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM Nr. 604, datë 14.09.2022 për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”, Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.*
- *Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zevendesimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).*
- *Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e koston në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen*
- *Klasifikimi i ofertave behet mbi bazen e vleres se ofertes se dhene ne total.*

Shtojca 5 ”Formulari i specifikimeve teknike”, pjesë e dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, ka përcaktuar si vijon:

#### **Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

*Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.*

#### **“Shërbimi me roje dhe sisteme elektronik”**

*1. Shërbim ruajtje në 2 (dy) vendroje, 1(nje) te Spitalit Librazhd dhe 1(nje) vendroje spitali Prrenjës, me tre turne (24 orë në ditë) në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata.*

2. Shërbim ruajtje me nga 1(nje) sinjal alarmi i objekteve; Godina e dispancerise qe eshte ne distance/periferi te territorit te spitalit me 1(një) sistem alarmi dhe 1(një) sistem alarmi në pjesën e pasme të godinës së spitalit (ku ndodhen magazinat), sipas orareve: 16.<sup>00</sup>-08.<sup>00</sup> e hene-e premtë, dhe me raste sipas kërkeses së AK-se dhe 24 ore (e shtunë e diele dhe ditët e festave zyrtare);

3. Shërbim monitorim i sistemit të kamerave vezhgimit të institucionit non stop 24 ore të ambjeteve jashtme të godinave të spitalit Librazhd dhe spitalit Prrenjas. Monitorimi ka për qëllim rritjen e sigurisë ruajtjes të pasurisë materiale në territorin e jashtëm të spitaleve.

**Kërkesat për zbatimin e shërbimit**

Punonjësit e shërbimit të jenë të licensuar me lejet përkatëse të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut ku prokurohet

Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga Ministria e Brendshme, ku të jetë e reklamuar dhe stema e shoqërisë dhe të kenë dokumente që vërtetojnë identitetin e tyre

Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.

Rojet duhet të kenë leje arme.

**Në vend roje duhet të jenë këto dokumente:**

a-Rregullorja e brendshme

b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.

c-Grafiku mujor i shërbimit me emrat e personelit për çdo ditë dhe turn.

d-Mjete ndriçimi në rast mungese të energjisë elektrike.

e-Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesore përgjegjës të objektit.

f-Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.

g-Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekt.

**Afatet e ekzekutimit:** 36 muaj ( i parashikuar)

Në shtojcën 6 “Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit” si dhe shtojcën 7 “Formulari i termave të referencës”, është parashikuar:

Shtojca 6

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet:

“Shërbimi i ruajtjes me roje dhe sistem elektronik” i DSH Spitalor Librazhd Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj.

**Shërbimit:**

Numri i Vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve të nevojshme	Afati i levrimit
--------------------	-----------------	-----------------------------	------------------

2 (Dy)	3 turne 24 orë cdo ditë kalendarike	9.96	Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 36 muaj.
4 (katër) objekte sistem elektronik	Sipas pershkrimit ne shtojca 5 specifikime teknike	Monitorim sisteme kamera vezhgimi non stop 24 ore dhe ruajtje dy objekti me sinjale alarmi	Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 36 muaj.

Kjo marreveshje Kuader dhe cdo minikontrate e lidhur me subjektin privat te sherbimit te sigurise do te konsiderohet e zgjidhur nese Shoqeria "ILLYRIAN GUARD" SHA shpreh mundesine e ofrimit te sherbimit te sigurise.  
Afatet e ekzekutimit: 36 muaj.

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

#### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

"Shërbimi i ruajtjes me roje dhe sistem elektronik" i DSH Spitalor Librazhd Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj.

Detyrat: Parandalimi, bllokimi, bashkepunimi me autoritetet e policise se rendit ne rastet e mundshme te vjedhjeve, demtimeve e shkaterrimeve te objekteve, prones dhe te pasurise se Drejtorise Sherbimit Spitalor Librazhd, per zbulimin dhe kapjen e autoreve.

Shpërndarja:

Sipas vendndodhjes objekteve Drejtorise Sherbimit Spitalor Librazhd sipas (shtojces 5)

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

1. Shërbim ruajtje në 2 (dy) vendroje, 1(nje) te Spitalit Librazhd dhe 1(nje) vendroje spitali Prrenjas, me tre turne (24 orë në ditë) në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata.

2.Shërbim ruajtje me nga 1(nje) sinjal alarmi objekteve; Godina e dispancerise qe eshte ne distance/periferi te territorit te spitalit me 1(një) sistem alarmi dhe 1(një) sistem alarmi në pjesën e pasme të godinës së spitalit (ku ndodhen magazinat), sipas orareve: 16.<sup>00</sup>-08.<sup>00</sup> e hene-e premtë, dhe me raste sipas kerkeses se AK-se dhe 24 ore (e shtune e diele dhe ditet e festave zyrtare);

3.Sherbim monitorim i sistemit te kamerave vezhgimit te institucionit non stop 24 ore te ambienteve te jashtme te godinave te spitalit Librazhd dhe spitalit Prrenjas. Monitorimi ka per qellim rritjen e sigurise ruajtjes te pasurise materiale ne territorin e jashtem te spitalleve.

III.7.2. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.7. është parashikuar:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizen e kostos për ofertën e paraqitur. (Shih Shtojca 1,2 - Sqarime)

III.7.3. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Kumria 1” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar:

1. Shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” ku çmimi total i ofertës pa TVSH rezulton të jetë në vlerën 24.788.841,22 lekë,
2. Shtojca 2 “Lista e çmimeve të shërbimeve”, e plotësuar për të gjitha zërat e parashikuara në dokumentet e tenderit.
3. Analizën e kostos për një roje dhe një vëndroje.

III.7.4. Në nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.*

*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

Në nenin 77, pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.7.5. Në nenin 82, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:*

a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigohet në bazë të tij.

b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigohet në bazë të tij.

c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigohet.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.”.

III.7.6. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, u ka kërkuar ofertuesve që të paraqesin ofertën e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos mujore, si edhe që gjatë këtyre përlllogaritjeve të merren parasysh të gjitha parashikimet ligjore në lidhje me pagën bazë minimale ligjore, shtesat për turnin e dytë e të tretë, kontributet shoqërore dhe shëndetësore për shërbimin e ruajtjes në një vendroje, me tre turne për një periudhë 36 muaj, ku bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vendroje me 3 turne (4.98 roje) në muaj. Gjithashtu, autoriteti kontraktor në kriteret për kualifikim ka përcaktuar që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizën e kostos për ofertën e paraqitur.

Nisur nga kërkesat e parashikuara nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga “Kumria 1” SHPK, informacionin dhe dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor dhe konstaton, se operatori ekonomik object ankimimi, ka paraqitur ofertë ekonomike në përputhje me elementët bazë (paga bazë minimale ligjore, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë si dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%) për një roje dhe një vendroje në muaj për të gjithë periudhën e shërbimit, sipas përcaktimit të bërë në dokumentet e tenderit duke mbajtur parasysh edhe faktin se në procedurat me afat 3 vjeçar në të cilin përfshihet edhe muaji shkurt me 29 ditë, përlllogaritjet e zërave të kostos lidhur me shtesat e turnit të dytë dhe të tretë mbi pagën bazë për një roje në muaj, janë llogaritur nga shoqëria “Kumria 1” SHPK me mesataren mujore 30.44 dite në muaj.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” SHPK se: “Se dyti, Autoriteti Kontraktor duhet te skualifikoje shoqerine KUMRIA 1 pasi nuk ploteson kerkesen e dhene ne DST shtojca 9, pasi nuk keni plotesuar sakte formularin permbledhes te vetedeklarimit dhe nuk keni deklaruar drejtuesin teknik dhe te gjithe personat ne cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, te cilet

kane kompetenca përfaqësuese vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

**Shtojca 9.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)  
**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

- I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:
- A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

**B: DEKLARATË**

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin
---

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</i>

*Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik*

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

*Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit*

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

*Deklarata*

*Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

*Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

*Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*

---

*etj.*

*nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.*

*Sqarime nëse vlerësohet e*

<p>nevojshme _____</p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</i></p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</i></p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p><i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</i></p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p><i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i></p> <p><i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i></p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p><i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</i></p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i></p> <p><i>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituruar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i></p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>

**B: DEKLARATA**

*Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura*

*Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020*



*“Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:*

- 1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*
- 2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;*
- 3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*
- 4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*
- 5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) Paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
  - b) Është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.**
- 6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*
  - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).**
- 7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6.a) dhe 6.b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
  - a) çmimet;*
  - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*
  - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
  - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.**
- 8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa te veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).*

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

#### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat,

*direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.*

**D: DEKLARATA**

*Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës*

*Deklarata*

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*

- *Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.*
- *Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.*
- *Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

**Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

**A: DEKLARATË**

*Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:*

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.</i>	<i>Po [ ] Jo [ ]</i>

**B: DEKLARATË**

*Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)*

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
------------------	------------------

<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u> Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, numri i punonjësve: _____</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve _____</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u> Po [ ] Jo [ ] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____</p> <hr/>
<p>Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.2.2. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, pika.1, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*Ofertuesi deklaron se:*

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;*
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;*
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;*
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*

*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.*

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.*

*Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.*

*Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*

*Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.*

*Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.*

III.2.3. Referuar ekstraktit historik të regjistrin tregtar të subjektit “Kumria 1” SHPK, rezulton se administrator i shoqërisë është z. I.K dhe Drejtues Teknik z. M.Ç nga data 16.11.2022. Gjithashtu, në këtë ekstrakt është pasqyruar se kanë ndodhur ndryshimet e mëposhme të drejtuesit teknik për nënkategorinë 1.2.A:

është shtuar anëtari: M.Cipi nga data 16.11.2022  
është larguar anëtari: Sh.Osmani

III.2.4. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Kumria 1”, SHPK ka dorëzuar Shtojcën 9 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, e cila rezulton e firmosur nga administratori i shoqërisë zoti I.K dhe përmban vulën e operatorit ekonomik “Kumria 1” SHPK. Në pjesën II: “*Shkaqet e përjashtimit*”, gërma A “*Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit*”, zoti I.K, në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik “Kumria 1” SHPK ka identifikuar se:

*Personi / personat në cilësinë e anetarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyresit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrese ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si me poshte:*

1. I.Kumrija, Administrator
2. Sh Osmani, Drejtues Teknik përpara dates 16.11.2022
3. M. Çipi, Drejtues Teknik i Ri

*nuk janë të denuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të percaktuara në nenin 76/1 të LPP-se ose kanë qene të denuar dhe ka kaluar qje periudhe 5-vjecare nga data e ekzekutimit të dënimit, nese nuk është percaktuar nje periudhe tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-se, etj.*

*Sqarime nese vleresohet e nevojshme Drejtoria e Përgjithshme Burgjeve (Gjendja gjyqësore).*

III.2.5. Në nenin 76 “*Kriteret detyruese për skualifikim*” të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” parashikohet shprehimisht se:

1. *Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është percaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:*

- a) *pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- b) *korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- c) *mashtim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- ç) *pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- d) *vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- dh) *falsifikim;*
- e) *puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.*

*Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarreje ose kontrolluese brenda tij.*

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja "ç", të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të

*përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;*

*f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.*

*g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit*

*Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*

*4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.*

*5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.*

*6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.*

*Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.*

*Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.*

*7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.*

**III.2.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:**

*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas*



parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

*Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.”*

III.2.7. Vendosija e kriterëve të kualifikimit kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

III.2.8. Për sa më sipër cituar, Komisioni gjykon, se shoqëria “Kumria 1” SHPK nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 76, pika 1 të nenin 76 të LPP-së sipas të cilit: “Çdo

*operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim; e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij”, pasi operatori ekonomik “Kumria 1” SHPK ka dorëzuar Shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, në të cilën është deklaruar administratori i shoqërisë si dhe drejtuesi teknik kategoria 1.3.A i larguar përpara datën 16.11.2022 dhe Drejtuesi i Ri Teknik pas kësaj date.*

Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik “Nazeri 2000” SHPK rezulton, se pretendohet veçanërisht për drejtuesin teknik të shoqërisë “Kumria 1” SHPK për të cilin Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se informacioni i dhënë në Formularin e vetëdeklarimit është i plotë dhe i saktë sikurse u sqarua më sipër.

Ndërsa për sa i përket pretendimeve se nga ana e kësaj shoqërie nuk është plotësuar sakte formulari përmbledhës i vetëdeklarimit dhe nuk janë deklaruar të gjithë personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, të cilët kanë kompetenca përfaqësuese vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime a-priori, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e deklaratës së shoqërisë “Kumria 1” SHPK.

Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastiit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Është barrë e operatorit ekonomik që të

përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për këto specifikime në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, pesha specifike e barrës për të provuar shkeljen e konstatuar qëndron mbi pretenduesin, i cili duhet të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërbushje kriteri.

Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” SHPK se: *“Se treti, Autoriteti Kontraktor duhet të skualifikoje shoqerine KUMRIA 1 pasi nuk ploteson kerkesen e dhene ne dst 2.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë pika 2.1.1, pasi licenca e shoqerise nuk ka të bashkëngjitur vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8 *“Kriteret e vecanta të kualifikimit”*, *“Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë”*, pika 2.1.1. rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

*Ofertuesi duhet të paraqesë:*

*Licensë e shoqerisë për ushtrimin e aktivitetit të “Sherbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike” e vlefshme, miratuar me vendim të DPP së shtetit për nënkategorinë 1.3.A, me veprimtari “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”, lëshuar nga QKL;*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Kumria 1” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Dy Licenca pa afat, me data lëshimi përkatësisht 01.10.2015 dhe 18.07.2019, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “Kumria 1” SHPK, me Kodin 1.3.A dhe kategori: *“Shërbim privat i sigurisë fizike”*. Emërimi përshkrues i veprimtarisë së licencës është: *“Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave si dhe veprimtarive social- kulturore, sportive, fetare e politike.”*

2. Vendimin nr. 184/6, datë 18.07.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas të cilit titullar subjekti SHPSF “Kumrija 1” SHPK është z.I.Kumrija dhe Drejtues teknik z. M.Çipi.
3. Vendimin nr. 184/7, datë 05.12.2022 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas të cilit titullar subjekti SHPSF “Kumrija 1” SHPK është z.I.Kumrija dhe Drejtues teknik z. Sh.Osmani.

III.3.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.”*

III.3.4. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- d) *Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë. për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.*

III.3.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka

në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në rastin konkret rezulton, se autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e tenderit që operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të *"Sherbimit te ruajtjes dhe sigurisë fizike"* e vlefshme, miratuar me vendim të DPP së Shtetit për nënkategorinë 1.3.A, me veprimtari *"Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike"*, lëshuar nga QKL, ndërkohë që shoqëria "Kumria 1" SHPK ka paraqitur licencën e shoqërisë me afat vlefshmërie *"Pa afat"*, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë "Kumria 1" SHPK, me Kodin 1.3.A dhe kategori: *"Shërbim privat i sigurisë fizike"*. Emërimi përshkrues i veprimtarisë së licencës është: *"Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave si dhe veprimtarive social- kulturore, sportive, fetare e politike, shoqëruar me vërtetimin përkatës lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit."*

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Nazeri 2000" SHPK se: *"Se katërti, Autoriteti Kontraktor duhet te skualifikoje shoqerine KUMRIA 1 pasi nuk ploteson kerkesen e dhene ne dst 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 2.2.1, pasi nuk keni paraqitur pasqyrat financiare per vitet e fundit 2019-2020-2021 sipas ligjit, pasi nuk kane te bashkangjitur raportin e auditimit per pasqyrat financiare sikurse parashikohet ne nenin 41 te ligjit 10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabël te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar.*

*Shoqeria KUMRIA 1 duhet te skualifikohet pasi permbush dy nga kushtet e nentit 41 germa c, te ligjit 10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabël te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar".*

*Në nenin 41, shkronja "c":*

*"c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:*

*i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;*

*ii)shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;*

*iii)ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."*

*Te njejtin qendrim mban edhe KPP me vendime te ngjashme nr. 581/2019 date 03.09.2019 ku shprehet se: "Referuar bazes ligjore te sipercituar, KPP morri ne shqyrtim dokumentacionin*

*e dorezuar prej operatorit ekonomik te siperpermendur, per te verifikuar nese ky ofertues permbush dy nga kushtet Cumulative te parashikuara ne ligjin e sipercituar per auditimin e pasqyrave financiare. KPP referuar pasqyrave financiare te dorezuara nga ofertuesi “Myrto Security” shpk per vitin 2018 permbush kushtet per totalin e aktiveve te bilancit dhe shumen e te ardhurave nga veprimtaria ekonomike, prandaj ka patur detyrimin per te paraqitur raportin e ekspertit kontabel te miratuar per bilancin e vitit 2018, sikurse parashikohet ne bazen ligjore te siperpermendur”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.4.1. Në Shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.1 të dokumentave të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*“Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore per tre vitet e fundit financiare (2019-2020-2021) sa vlera e perlllogaritur e kontratës, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse arrihet vlera e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar. Bilancet per tre vitet e fundit financiare 2019-2020-2021, te konfirmuara nga organet tatimore dhe konforme kerkesave te ligjit nr.10091 date 05.03.2009, kerkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e kërkuara në dy vite të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.*

III.4.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Kumria 1” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Pasqyrat Financiare për Vitin 2019, të shoqëruar me Raport të Audituesit të Pavarur.
- Pasqyrat Financiare për Vitin 2020, të shoqëruar me Raport të Audituesit të Pavarur.
- Pasqyrat Financiare për Vitin 2021, të pa shoqëruar me Raport të Audituesit të Pavarur.

III.4.3. Në nenin Neni 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.4.4. Në nenin Neni 92, pika 3 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

III.4.5. Në nenin 41 “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare”, të Ligjit 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:

a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar;

b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit;

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

III.4.6. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Kumria 1” SHPK, për të verifikuar nëse ky ofertues përmbush dy nga kushtet kumulative të parashikuara në ligjin e sipërcituar për auditimin e pasqyrave financiare. KPP referuar pasqyrave financiare të dorëzuara nga ofertuesi “Kumria 1” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur raportet e auditit për pasqyrat financiare të viteve 2019 dhe 2020, por nuk ka patur detyrimin për të paraqitur raportin e auditit për pasqyrat financiare të vitit 2021, sikurse parashikohet në bazën ligjore të sipërpërmendur, pasi nuk plotëson të paktën dy prej tre treguesve të parashikuar në nenin 41 të Ligjit 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, si më sipër cituar

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Nazeri 2000” SHPK nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” SHPK se: “*Se pesti, Autoriteti Kontraktor duhet të skualifikojë shoqerine KUMRIA 1 pasi nuk plotëson kerkesen e dhene ne dst 2.3 Kapaciteti teknik pika 2.2.4, pasi ne vertetimin e performances se paraqitur nuk jepen te dhena te sakta per drejtuesin teknik aktual te cilin e ka te deklaruar ne QKB por jepen per drejtuesin teknik te vjeter i cili eshte larguar*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 8 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*”, pika 2.3.4 e dokumenteve të tenderit rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

*Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim përformance nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, lëshuar pas datës 1 Nentor 2022, në të cilën të pasqyrohet informacioni: -Objektet në ruajtje me numrin e punonjesve të certifikuar për jo më pak se 10 (dhjetë); -Të ketë qendër kontrolli me 5(pesë) operator dhe grup të gatshëm 24 orë (tre turne) me 2(dy) punonjës për çdo turn gjithsej 6 (gjashtë); -Të ketë një përgjegjës shërbimi; -Të mos ketë marrë masë administrative nga policia e shtetit për Subjektin, Titullarin dhe Drejtuesin Teknik sipas deklartimit QKB-se për periudhën vitin 2021-2022 (të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për SHPSF-të);*



III.5.2. Për plotësimin e kërkesës së sipërcituar, operatori ekonomik “Kumria 1” SHPK ka paraqitur shkresën me nr. 9718/1 prot., datë 13.12.2022 me objekt: “Performanca e subjektit të SHPSF-së “Kumria 1” SHPK”, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan.

III.5.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.5.4. Në nenin Neni 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të*

*njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.5.5. Në nenin Neni 92, pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “ 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

III.5.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Kumria 1” SHPK rezulton se është paraqitur shkresa me nr. 9718/1 prot., datë 13.12.2022 me objekt: “Performanca e subjektit të SHPSF-së “Kumria 1” SHPK”, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, në pikën I “Të dhëna të plota në lidhje me subjektin”, gërma “a” thuhet shprehimisht:

*“Subjekti “ Kumria 1” SHPK është pajisur me licencë nënkategoria 1.3 A, sipas vendimit nr. 184/7, datë 05.12.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit me titullar subjekti z.I.Kumrija dhe Drejtues Teknik z.M.Cipi, me certifikatë nr.727, datë 10.10.2022, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në fushën e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike.”*

Referuar ekstraktit historik të regjistrit tregtar të subjektit “Kumria 1” SHPK, rezulton, se administrator i shoqërisë është z. I.K dhe Drejtues Teknik z. M.Ç nga data 16.11.2022. Gjithashtu në këtë ekstrakt është pasqyruar, se kanë ndodhur ndryshimet e mëposhme të drejtuesit teknik për nënkategorinë 1.2.A:

*është shtuar anëtari: M.Cipi nga data 16.11.2022*  
*është larguar anëtari: Sh.Osmani*

III.5.7. Sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se shoqëria “ Kumria 1” SHPK, ka paraqitur vërtetim performace nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, në të cilën përfshihet informacioni lidhur me drejtuesin teknik të shoqërisë z.M.Cipi, i cili rezulton drejtuesi i ri teknik sipas ekstraktit të QKB-së, që ka zëvendësuar Drejtuesin Teknik z. Sh.Osmani, duke filluar nga data 16.11.2022, ndërkohë që shkresa në fjalë është lëshuar nga

Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan në datën 13.12.2022, pas zëvendësimit të drejtuesit teknik. Për rrjedhojë KPP gjykon, se pretendimi i ankimuesit *ne vertetimin e performances se paraqitur* nga shoqëria “Kumria 1” SHPK *nuk jepen te dhena te sakta per drejtuesin teknik aktual te cilin e ka te deklaruar ne QKB por jepen per drejtuesin teknik te vjeter i cili eshte larguar* nuk rezulton i drejtë në rastin konkret. KPP gjykon, se operatori ekonomik “Kumria 1” SHPK ka dorëzuar dokumentacion në përputhje me kriterin e kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” SHPK nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” SHPK se: *“Se gjashti, Autoriteti Kontraktor duhet te skualifikoje shoqerine KUMRIA 1, pasi nuk ploteson kerkesen e dhene ne dst 2.3 Kapaciteti teknik pika 2.2.5, pasi drejtuesi teknik nuk eshte i siguruar tre muajt e fundit ashtu si kerkohet ne DST”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 8 “ *Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*”, pika 2.3.5 e dokumenteve të tenderit rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit që përkojnë sipas legjislacionit tatimor me hapjen e tenderit, të shoqëruar me listëpagesat kontributeve të sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025/a) për këtë periudhë. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 12 (dymbëdhjetë) të siguruar për çdo muaj, drejtuesin teknik dhe administratorin dhe 10 (dhjetë) punonjës shërbimi/roje objekti të certifikuar nga DVPolicisë Elbasan.*

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DT. Dokumentat e kerkuara me sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor gjatë procedurës, duhet te dorezoje dokumentet provuese per vetedeklarimet qe ka bere ne formularin permbledhes te vete deklarimit (neni 82, pika 2 LPP dhe neni 26, RrPP).*

III.6.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Kumria 1” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9), të plotësuar prej tij, ku në Deklaratën për disponimin e punonjësve është deklaruar 1 (nje) Drejtues Teknik i certifikuar nga DPP shtetit nënkategori 1.3.A. Gjithashtu, nga ana e shoqërisë “Kumria 1” SHPK janë paraqitur listëpagesat e shoqërisë për periudhën shtator 2022- nëntor 2022.

Referuar ekstraktit historik të regjistrit tregtar të subjektit “Kumria 1” SHPK, rezulton, se administrator i shoqërisë është z. I.K dhe Drejtues Teknik z. M.Ç nga data 16.11.2022. Gjithashtu, në këtë ekstrakt është pasqyruar, se kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme të drejtuesit teknik për nënkategorinë 1.2.A:

*është shtuar anëtari: M.Cipi nga data 16.11.2022*  
*është larguar anëtari: Sh.Osmani*

III.6.3. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e

*duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

*konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

III.6.4. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.*

III.6.5. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.6.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Kumria 1” SHPK rezulton, se është paraqitur Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit (shtojca 9), ku në Deklaratën për disponimin e punonjësve është deklaruar 1 (një) Drejtues Teknik i certifikuar nga DPP shtetit nënkategori 1.3.A si dhe janë paraqitur listëpagesat e shoqërisë për periudhën shtator 2022 - nëntor 2022. Nga verifikimi i listëpagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, rezulton, se në këto listëpagesa figuron z.Sh.Osmani për muajt shtator, tetor dhe disa ditë nga muaji nëntor (13 ditë), ndërsa z.M.Cipi, drejtuesi i ri teknik i shoqërisë, sipas ekstraktit të QKB-së si më sipër cituar, figuron në listëpagesën e shoqërisë “Kumria 1” SHPK për periudhën e mbetur të muajit nëntor (9 ditë). Për rrjedhojë Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Kumria 1” SHPK ka dorëzuar dokumentacion në përputhje me kriterin e kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” ShPK nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për sa i përket mënyrës së hedhjes së shortit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe nga verifikimet e kryera në SPE rezulton, se në datën 13.01.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Kumria -1” SHPK 24.788.841,22 lekë, kualifikuar
2. “Nazeri 2000” SHPK 24.788.841,22 lekë, kualifikuar

III.7.2. Në datën 16.01.2023 KVO-ja ka njoftuar elektronikisht ofertuesit nëpërmjet SPE-së për hedhjen e shortit, meqenëse dy shoqëritë pjesëmarrëse në tender dhe të kualifikuara, kanë ofertuar me çmim të njëjtë. Konkretisht janë njoftuar si vijon:

*“I nderuar operator ekonomik ju keni marrë pjesë në procedurën e zhvilluar nga autoriteti kontraktor me objekt "Shërbime të ruajtjes dhe të sigurisë fizike" Drejtorisë Shërbimit Spitalor Librazhd. Pas përfundimit të fazës së vlerësimit të dokumentacionit të dërguar nga ana Juaj na rezulton se Ju keni paraqitur ofertë ekonomike në vlerën prej 24,788,841.22 lekë pa tvsh e cila është e njëjtë me ofertën ekonomike të paraqitur nga një operator tjetër ofertues. Në respekt të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ju njoftojmë se në datë 17.01.2023 ora 15.00 autoriteti kontraktor sipas adresës të përcaktuar në dokumentacionet e tenderit do të zhvillojë procedurën e shortit. Përfaqësuesi Juaj duhet të jetë i pajisur me autorizim nga ana Juaj dhe me vete duhet të ketë edhe Kartën e Identitetit, për të marrë pjesë në këtë procedurë shorti. Mos pjesëmarrja në këtë procedurë nuk pengon vazhdimin e procedurës së shortit. Ju faleminderit!.*

III.7.3. Në datën dhe në orën e caktuar në ambientet e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Librazhd janë paraqitur përfaqësuesit e të dy shoqërive, “Kumria 1” SHPK dhe “Nazeri 2000” SHPK, të pajisur me autorizimet përkatëse.

Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së hedhjes së shortit autoriteti kontraktor informon si vijon:

*“Përpara se të fillohej me procedurën e hedhjes së shortit nga ana e komisionit u bë e ditur përfaqësuesve të operatorëve ekonomikë mënyra e zhvillimit të procedurës së hedhjes së këtij shorti, që do të jetë: Nga ½ fletë letër formati A4 të bardha të reja me përmasa të njëjta shënohet me shkrime të njëjta me kompjuter në njërin “Fitues” dhe në tjetrën “Humbës” dhe do të palosen njëherë që të mos identifikohen në shikim gjatë përzierjes, pastaj do të futet secila në një zarf të vogël të bardhë me madhësi të njëjtë. Komisioni do t’i përziejë në prani të operatorëve ekonomikë dhe më pas do të tërhiqen nga vet secili operator pjesëmarrës i shortit, duke e hapur dhe treguar letrën me mbishkrimin që përmban përpara komisionit. Operatori ekonomik që do të tërheqë zarfin me shkrimin “Fitues” do të shpallej fitues i këtij shorti.*

*Të dy operatorët ekonomikë nuk shprehën ndonjë vërejtje vetëm kërkuar që zarfet të përzihen disa herë në tavolinë në sy të përfaqësuesve të operatorëve konkurrues nga komisioni dhe të kthehen duart me zarfe nga mbrapa për përzierje tjetër disa herë pastaj ti vendosin në tavolinë. Dhe komisioni në transparencë të plotë përpara përfaqësuesve të operatorëve pjesëmarrës të shortit i tregoi të dyja fletët e bardha të reja ½ fletë letër formati A4 që në njërin shënohej “Fitues” dhe në tjetrën “Humbës” dhe i mbylli zarfet duke i ngjitur kapakët*

*që zarfi ka vet për ngjitje, i përzjeu disa herë në tavolinë dhe duke kthyer duart me secilën me nga një zarf nga mbrapa për përzjerje tjetër disa herë dhe më pas ftoi operatorët pjesëmarrës të tërheqin nga një zarf në tavolinën e komisionit në mënyrë të lirë sipas renditjes së klasifikimit të ofertave të operatorëve nga ( SPE) dhe ta hapin para komisionit, duke treguar procesin e hapjes dhe mbishkrimin që përmban letra brenda zarfit. Përfaqësuesi i operatorit ekonomik “Kumria 1” SHPK zgjodhi një nga zarfet ku brenda tij ishte letra me mbishkrimin “Fitues”. Në këtë kohë përfaqësuesi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” SHPK, duke parë se zarfi me mbishkrimin “Fitues” u tërhoq nga operatori ekonomik “Kumria 1” SHPK, nuk tërhoqi zarfin tjetër, duke ngritur pretendime hipotetike, absurde dhe pa asnjë argument ligjor bindës. Në këto kushte komisioni në prani të tyre hapi edhe zarfin e dytë, duke e bërë të ditur se në këtë zarf ishte mbishkrimi “Humbës”. Përfaqësuesi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” SHPK i cili nuk u shpall fituesi këtij shorti, kërkonte që procesi i shortit të përsëritej edhe njëherë me pretendime hipotetike pa asnjë argument ligjor bindës, ndërkohë operatori tjetër i shpallur fitues i këtij shorti kërkonte që komisioni të vijojë punën me hapa të mëtejshme se tashmë ai është fitues i një procesi të rregullt të shortit. Komisioni duke qenë përballë faktit të përfundimit të procesit të hedhjes së shortit nga njëra anë dhe pretendimeve hipotetike pa asnjë argument ligjor bindës të operatorit që nuk rezultoi fitues, vendosi të miratojë këtë procedurë zhvillimi të shortit të rregullt konform ligjit dhe në përfundim me unanimitet të shpallë fitues të shortit operatorin ekonomik “Kumria 1” SHPK.”*

III.7.4. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se referuar procesverbalit të zhvillimit të shortit datë 17.01.2023, vënë në dispozicion nga AK, rezulton, se pjesëmarrës në procedurën e zhvillimit të shortit kanë qenë përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” SHPK dhe përfaqësuesi i shoqërisë “Kumria 1” SHPK. Referuar procesverbalit të zhvillimit të shortit, rezulton, se përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” SHPK, i cili ka qenë prezent në procedurën e zhvillimit të shortit, nuk e ka nënshkruar procesverbalin përkatës.

III.7.5. Referuar argumenteve të ankimuesit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor KPP gjykon, se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është mbajtur asnjë procesverbal, dokument apo formë tjerër të parashikuar nga ligji, lidhur me mënyrën e hedhjes së shortit, proces i cili duhet të sigurojë dakortësinë e të dyja palëve të interesuara. Në procesverbalin e datën 17.01.2023, mbi zhvillimin e procedurës së hedhjes së shortit për përcaktimin e fituesit ndërmjet operatorëve me ofertë ekonomike të njëjtë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se tërheqja e zarfeve është bërë sipas renditjes së klasifikimit të ofertave, gjë e cila nuk mund të konsiderohet se është vendosur me konsensus, përderisa shoqëria ankimuese e kundërshton dhe autoriteti kontraktor nuk ka asnjë provë që të vërtetojë pohimin e tij se të dy operatorët ekonomikë nuk shprehën ndonjë vërejtje. Gjithashtu, nga shqyrtimi i procesverbalit të KVO-së për procesin e hedhjes së shortit si më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se mungon nënshkrimi i operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” SHPK, duke e kthyer këtë procedurë në të njëanshme.

III.7.6. Komisioni sqaron, se organizimi i shortit është në diskrecion të plotë të autoritetit kontraktor mjafton që të respektohen hapat proceduralë për njoftimin e rregullt të ofertuesve

për t'u dhënë atyre mundësi të marrin pjesë në procedurën e hedhjes së shortit në mënyrë që të garantohet transparenca dhe barazia në trajtimin e ofertuesve.

Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, kur përgatisin ofertat e tyre, kur të vlerësohen ato si dhe gjatë hedhjes së shortit. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 *“Për prokurimin publik”* ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparenca e në mënyrë proporcionale.

III.7.7. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se parregullsitë e konstatuara në procedurën e ndjekur nga KVO-ja për hedhjen e shortit përbëjnë shkak për anulimin e shortit dhe përsëritjen e tij, me qëllim trajtimin e barabartë, transparent dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë.*

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,



## Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” SHPK” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-54848-12-22-2022, me objekt: “*Shërbime të ruajtjes dhe të sigurisë*” Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Librazhd -Marrëveshje Kuadër – me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj” me fond limit 25,508,841 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 098.01.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Librazhd.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e hedhjes së shortit, duke e përsëritur atë në përputhje me konstatimet e KPP-së në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Nazeri 2000” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**